

ALI DHRIMO

### NJË VËSHTRIM MBI FOLJET ME MË SE NJË REKSION NË SHQIPEN E SOTME LETRARE

Problemi i reksionit në përgjithësi e veçanërisht ai foljor në planin thjesht teorik në gramatikat e shqipes nuk është trajtuar; nuk ka punime të veçantë për të. Megjithatë, siç do të vihet re më posht, nëpër gramatikat e ndryshme të shqipes ka zbatime të parimeve të reksionit dhe prekje të pjesëshme të këtij problemi.

Edhe në gjuhësinë e përgjithëshme ka pikëpamje të ndryshme lidhur me reksionin. Në nocionin përkatës Marouzeau sheh «vetinë që ka një fjalë të bashkohet me një tjetër»<sup>1</sup> Gjuhëtari rus Potebnja, duke shqyrtuar gjymtyrët e dyta të fjalisë dhe llojet e bashkimit të tyre me gjymtyrët kryesore, i ka kushtuar një vemendje të posaçme reksionit, të cilin e përkufizon kështu: «Reksion quhet një bashkim i tillë fjalësh, në të cilin njëra fjalë varet nga tjetra»<sup>2</sup>. Këtë përkufizim të reksionit ai e jep krahas atij të përshtatjes, me të cilën kupton «një bashkim të tillë fjalësh, ku njëra fjalë ia përqs mbaresën e vet mbaresës së fjalës tjetër»<sup>3</sup>. Fjalët e sunduara i quan *plotësuese*, ndërsa të përshtaturat *përcaktuese*. Ai merret më tej me kalimin e bashkimeve nga ndërtimi me reksion në atë me përshtatje. Gjithë raportet midis gjymtyrëve të fjalisë — nënvizon autori — duhen përfshirë brenda dy nocioneve: përshtatje e reksion dhe gjymtyrët e dyta duhet të jenë patjetër përcaktuese ose plotësuese; por, përveç këtyre dy lloj gjymtyrëve, duhen dalluar, simbas tij, edhe gjymtyrë të tilla fjalësh, të cilat nuk qendrojnë në një lidhje sintaktike të dukëshme me fjalët me të cilat bashkohen, dmth. as përshtaten as sundohen, p.sh. «shumë i mirë», «shkoj në qytet». «Fjalë të tilla emërtohen rrethanore».

Një përkufizim të reksionit jep edhe Peshkovski: ««Reksion» është nënrenditja e emrit ndaj çfarëdo fjale tjetër»<sup>4</sup>.

Ndërkaq, për t'i dhënë nocionit përkatës një karakter mundësisht më të përgjithshëm, ne vetë reksionit do t'i jepnim këtë përkufizim: Reksion i një fjale së dhënë është sundimi a drejtimi i një fjale tjetër nga fjala e dhënë. Fjalën që sundon a drejton fjalën tjetër do ta quajmë *sunduese*, ndërsa atë që sundohet të *sunduar*.

Fjala sunduese mund të jetë emër, mbiemër, parafjalë dhe folje;

1) J. Marouzeau: «Lexique de la terminologie linguistique» — Paris — 1951, f. 195

2,3) A. A. Потебня: „Из записок по русской грамматике“ — Москва — 1958 — стр. 74-75, 76, 120.

4) A. M. Пешковский: Русский синтаксис в научном освещении — Москва — 1938, стр. 84.

të sunduarën e përbën kryesisht një emër ose një fjalë tjetër me vlerë emri, por mund ta përbëjë edhe një folje në paskajore. Madje të sunduarën mund ta përbëjë edhe një fjali e tërë e varur.

Rregullisht, emrat, mbiemrat, parafjalët dhe foljet kanë nga një reksion të vetëm. Por në gjuhët indoeuropiane nuk janë aq të rralla çfaqjet e emrave, mbiemrave, parafjalëve dhe foljeve me më se një reksion. Temë e kësaj kumtese janë pikërisht çfaqjet e foljeve me më se një reksion në shqipen e sotme letrare.

Vartësia e fjalës së sunduar nga folja sundojëse shprehet me anë qoftë vetëm të mbaresës rasore përkatëse qoftë njëherazi edhe të një parafjale. Ne do të marrim në shqyrtim vetëm rastin e parë, pra, vartësinë direkte të emrit nga folja, pa ndërmjetësinë e parafjalëve.

Trajtimi i këtij problemi na u duk i rëndësishëm, sepse edhe në gjuhën shqipe, sikurse në simotrat e saj indoeuropiane, nuk ka asnjë ndryshim morfologjik midis foljeve tranzitive (kalimtare) dhe intranzitive (jo-kalimtare) dhe ndarja e tyre mbështetet kryesisht në tiparet sintaktikë e ndonjëherë formëformonjës (për rusishten edhe fjalëformonjës)<sup>5</sup>. Ndryshimi semantik midis foljeve tranzitive dhe intranzitive konsiston në faktin që folja tranzitive shpreh një lidhje të detyrueshme dhe të ngushtë të veprimit, jo vetëm me subjektin, por edhe me objektin e tij (kalimi i veprimit nga subjekti mbi objektin). Në tiparet sintaktikë hyjnë konstruktet e foljeve tranzitive me kundrinë të drejtë prkt. të zhdrejtë. Në tiparet formëformues hyn mundësia e ndërtimit të formave me kuptim pësor nga foljet tranzitive, gjë që, për dy vetat e para njëjës dhe për vetën e tretë shumës, është e pamundur për foljet intranzitive. Por duhet thënë që kjo gjëndje vazhdimisht ndryshon dhe, me rrjedhjen e kohës, shohim se shumë folje, të cilat më parë nuk pranonin konstruktet me rasën kallëzore, ose përdorjen e tyre pa këtë rasë, tani kanë filluar, dhe vazhdojnë gjithmonë e më tepër, t'i pranojnë ata. Por trajtimi shkencor sado modest i kësaj teme kërkon përmendjen paraprake të trajtimit të saj nga autorët e huaj e vendas. Në gramatikën e Akademisë së Shkencave të B. S. reksioni nuk trajtohet veçanërisht, por flitet atje për mundësitë e kalimit të një foljeje nga tranzitive në intranzitive dhe anasjelltas, si edhe për dallimet e tyre. Kështu thuhet se «foljet tranzitive dhe intranzitive dallohen simbas bashkimit me rasën kallëzore të kundrinës së drjetë (d.m.th. sintaktikisht). Por vetë kjo veti sintaktike e foljeve është e lidhur me kuptimin e tyre leksikor...»<sup>6</sup>

Po këtu e shikon arësyen e kalimit nga folja tranzitive në atë intranzitive edhe Gvozdievi, i cili nënvizon se «forcimi ose dobësimi i lidhjes me objektin çon në kalimin e foljeve nga tranzitive në intranzitive dhe anasjelltas»<sup>7</sup>

Walter Jung, duke bërë fjalë për reksionin foljor, thotë: «Pothuajse çdo folje ka një ose dy rasa, të cilat i rrinë asaj veçanërisht afër si

5) Shih: Шор-Чемоданов: „Введение в языковедение“ Москва — 1945, стр. 125-126.

6) Академия Наук СССР: „Грамматика русского языка“, Москва, 1958, I, стр. 411-413.

7) Гвоздев, А. А. Н.: „Современный русский язык“. Москва. 1958. стр. 276-279.

forma të nënrenditura (të varura). Shpesh duhet përmendur edhe rrasa përkatëse së bashku me foljen, sepse kuptimi i foljes është, simbas formës së objektit, i ndryshëm, pavarësisht nga fakti që kuptimi themelor i saj depërton në të gjithë rastet. Ky objekt sundohet, drejtohet nga folja dhe pikërisht këtë drejtim a sundim e quajmë reksion të foljes». <sup>8</sup>

Përsa u përket autorëve shqiptarë, trajtimin e kalimit të foljevet tranzitive në intransitive e anasjelltas e hasim për herë të parë në «Gramatika shqipe» të K. Cipos. Pra, ky autor ka meritën, që futi i pari në gramatikën tonë trajtimin e kësaj veçorie gjuhësore. Autori shprehet kështu: «Ka nonjë folje që është njëkohësisht edhe tranzitive edhe intransitive. Foljet: *shpëtoj, qaj, ndroj* i kanë të dy diatezat. P.sh. *shpëtova* për qime (diat. intransitive), e *shpëtova* nga një rrezik (diat. tranzitive)...»<sup>9</sup>. Për të sqaruar më tepër këtë mendim në thelb të drejtë, ne do të vërejmë se shprehja: «është njëkohësisht tranzitive dhe intransitive» duhet interpretuar kështu: në disa bashkime sintaktike është tranzitive e në disa të tjerë intransitive, por pa bashkëbarrtur në asnjërin nga të dy rastet njëherazi tranzitivitetin dhe intransitivitetin. Edhe shprehja: «i kanë të dy diatezat» duhet kuptuar: i kanë të dy reksionet, — sepse parimet e ndarjes së foljeve në diateza janë krejt të ndryshëm nga ata të ndarjes së tyre në folje me një ose më se një reksion. K. Cipua bën edhe disa vërejtje të tjera lidhur me këte grup foljesh, por pa i bërë objekt të afërt studimi e pa analizuar shkaqet e kalimit të tyre nga njëri reksion në tjetrin.

Në dispensën «Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe» Sh. Demiraj vërtet nuk jep përkufizimin e reksionit në veçanti, por shënon shprehimisht se «disa folje tranzitive përdoren herë-herë si intransitive dhe anasjelltas, disa intransitive përdoren herë-herë si tranzitive.»<sup>10</sup> Ai merret shkurtimisht edhe me nuancat e ndryshme kuptimore që lindin në këtë rast.

Në një punim të pambaruar mbi foljet e shqipes, S. Riza reksionin e foljes e përkufizon kështu:

«Reksion (lat. rectionem = qeverisje, sundim, drejtim) i një foljeje veprimi quhet raporti i vetë foljes si skaj drejtues ndaj kundrinës së saj si skaj i drejtuar.

Mjaft folje të gjuhës shqipe njohin nga *dy apo tre reksione të ndryshëm* me domethënie leksikore pjesërisht të ndryshme.»

Në këtë kumtesë do të merremi pikërisht me problemin e fundit, prekur nga K. Cipua, Sh. Demiraj e S. Riza — me ato folje që kanë më se një reksion, d.m.th. që sundojnë më se një rasë e si të tilla në disa bashkime sintaktike janë tranzitive të drejta, në disa të tjerë të zhdrejta e në disa intransitive ose anasjelltas.

Zakonisht plurireksionaliteti i një foljeje së dhënë sjell me vehte një diferencim në kuptimin e saj leksikor p.sh.

a) shërbej atdheut (= «i sjell dobi, i hyj në punë»); kurse

b) shërbej një klient (= i jap të hajë e të pijë).

8) Walter Jung: «Kleine Grammatik der deutschen Sprache», Leipzig, 1955, f. 44.

9) K. Cipo: «Gramatika shqipe», Tiranë, 1949, f. 109.

10) Sh. Demiraj: «Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe», Tiranë, 1963 II, f. 170-172.

Ky diferencim në kuptimin leksikor të foljes është veçanërisht i rëndësishëm atëherë, kur si rezultat i ndryshimit të reksionit linden folje kauzative p.sh.

a) gaboj (= jam në gabim, bëj gabim); kurse

b) më gabon syri (= më bën të gaboj, më shtie në gabim, (shiko edhe Ia).

Por ky diferencim duhet dalluar nga polisemia leksikore e mirëfilltë e foljes së dhënë; sadoqë edhe vetë plurireksionaliteti kushtëzohet deri diku nga polisemia përkatëse.

Kështu shpjegohet edhe mundësia që një numuri relativisht të madh kuptimesh leksikore të një foljeje t'i përgjigjen herë tre reksione p.sh.:

— Mos *thirrë* kot (= mos bëj zë; mos folë me zë të lartë) (intr.)

— Ç'i *thërret* më tani! (= ç'e qërton) (tr. e zhdr.)

— E *thirre* për darkë edhe atë, apo jo? (= e ftove) (tr. edr.), herë dy reksione p.sh.

— Vajza po *qan* (derdh lot, vajton) (intr.)

— Më *qan* zemra në ty (= dyshoj) (intr.)

— E *qan* te vellanë (= e vajton) (tr. edr.)

— E *qan* me lot ruishten (= e zotëron) (tr. e dr.) e herë një reksion i vetëm p.sh.

— ai *shkon* (= lëviz drejt një vendi) (intr.),

— *shkon* koha (= kalon) (intr.)

— *shkon* stofi (= shitet) (intr.)

— *shkon* leku (= shpenzohet)

— *shkon* fjala (= ka vlerë)<sup>11</sup>.

Si folje intranzitive do të marrim foljet e gjendjes, të livizjes në hapësirë dhe ato folje të veprimit, në të cilat ky i fundit parafytyrohet i paushtruar mbi dikë a diçka p.sh.

*rri, fle, qëndro, shkoj, eci, vij, humbi lapsi, ngrij* etj.

Si folje tranzitive do të marrim ato folje të veprimit, në të cilat ky i fundit parafytyrohet i ushtruar mbi dikë a diçka qoftë direkt, qoftë indirekt, pra, si ato që sundojnë rasën kallëzore ashtu edhe ato që sundojnë atë dhanore p.sh.

*marr, lexoj, punoj, i thom, i flas, i kundërshtoj* etj.

Siç u vu në dukje edhe më lart, për punimin tonë vijnë në konsideratë jo vetëm foljet e veprimit, por edhe ato folje të gjendjes e lëvizjes, të cilat në disa bashkime sintaktikë përdoren si tranzitive p.sh. *i rri* punës sipër; *i dal* mb'anë, *i qëndro* armikut etj.

Për foljet intranzitive, dmth. për të gjitha ato folje, të cilat në kuptimin a kuptimet e dhënë nuk marrin dot asnjë plotës kundrinor, do të themi se kanë reksionin zero.

Foljet me më se një reksion do t'i ndajmë në dy grupe:

A. — Folje me dy reksione dhe

B. — Folje me tre reksione.

A. — Foljet me dy reksione përfshijnë numurin më të madh të foljeve plurireksionale të gjuhës shqipe. Këtë grup foljesh ne do ta ndajmë përsëri në tre nëngrupe:

I. Folje me reksion: 1) intranzitiv e 2) tranzitiv të drejtë;

II. Folje me reksion: 1) intranzitiv e 2) tranzitiv të zhdrejtë, dhe

11) Shih edhe J. Stefi: «Leksikologjia shqipe», Tiranë, 1961, f. 23-24.

III. Folje me reksion: 1) tranzitiv të zhdrejtë e 2) tranzitiv të drejtë.

I. Edhe foljet e këtij nëngrupi në radhën e vet do të ndahen në dy nëngrupe të tjerë e pikërisht në:

Ia. Folje reksioni primar i të cilavet është ai intranzitiv dhe vetëm si sekundar\*, e madje jo pa ndryshuar pjesërisht kuptimin e tyre leksikor, njohin edhe reksionin tranzitiv të drejtë p.sh.:

— Nga njëherë *kalonin* javë të tëra pa i ardhur njeri. (intr.) V. Sejko: Orë të vështira f. 21.

— Latifi me Mexhitin *kalonin* kohën e lirë duke luajtur bixhos (tr. e dr.) Q. Buxheli: Kali mbretit. ., F. 290.

— Partizanët *vdin* me këngë në gojë (intr.)

— E rrahu sa e *vdia*, se foli me fqinjën (tr. e dr.)

Në këtë nëngrup foljesh hyjnë: 1) *avulloj, çaloj, dimëroj, hypi, gaboj, gajas, lëviz, ngordh, plas, pushoj, qëndroj, shëtit, vdes, veroj, zbres*, etj.

2) a) *ëndëroj, arësyetoj, gënjej, has, jetoj, katandis, pështyj, qesh, qaj*, etj.

b) *duroj, gjykoj, bisedoj, kuvëndo, luftoj, mendoj, mund, punoj, qëndis, pres, vua, etj.*

Foljet e grupit të parë, kur kalojnë nga reksioni intranzitiv në atë tranzitiv të drejtë, kthehen në faktive prkt. kuazative<sup>12</sup>. Në këtë rast personi ose sendi i treguar nga objekti (kundrina e drejtë) duhet të kryejë veprimin e treguar nga folja p.sh. Nëna e *shëtit* djalin çdo ditë nëpër park. Në këtë rast *shetit* tregon veprimin, i cili faktikisht kryhet nga kundrina e drejtë, nga fëmija, sepse ai shëtit; nëna vetëm «e bën të shëtisë». Prandaj thamë që në këta konstrukte kemi ndryshim të pjesshëm të kuptimit leksikor të foljes; ajo shpreh kuptimin e «sjelljes në këtë gjendje»: *e vdes* — dmth. *e bëj të vdes*; *e ngordh* — *e bëj të ngordhë*; *e kërcas* — *e bëj të kërcasë*, etj.

Foljet e grupit të dytë a e ndryshojnë reksionin primar intranzitiv në atë sekundar tranzitiv kryesisht nën veprimin e polisemisë së tyre p.sh.

— Ai *ëndëron* me sy hapët (= sheh ëndra) (intr.)

— As mos e *ëndëro* atë lumturi (imagjino, sill nder mënd) (tr. e dr.)

— «Lutemi mos *pështyni* për tokë» (lëshoni pështymë) (intr.)

— E *pështyu* gjithë kolektivi (= i hodhi pështymën) (tr. e dr.)

Po kështu ndodh edhe me foljet e grupit të dytë b, të cilat në dukjen e parë të lenë përshtypjen se janë tranzitive të drejta. Në të vërtetë edhe këto kanë si reksion primar atë intranzitiv dhe idenë që lind në vështrimin e parë në e shpjegojmë me përdorimin e madh që kanë si tranzitive. Pra, ne, perderisa pranojmë se reksioni primar i këtyre është intranzitiv dhe se përdorimi i tyre me një emër në kallëzore është një çfaqje e vonë, një inovacion sekundar, në konstrukte të tillë:

12) Marouzeau — *vep. e cituar*, fq. 44 — foljet kauzative i përkufizon kështu: «Kauzativ = formë foljore e aftë për të treguar se kryefjala vë dikë tjetër që të kryejë veprimin, nëvendqë ta kryejë vetë.»

\*) Për karakterin primar a sekundar të reksionit tranzitiv apo intranzitiv të foljeve jemi mbështetur në Fjalorin e Institutit të Shkencave botuar në Tiranë më 1954.

*duro*, se ka dhe për ty; *gjyko* drejtë; *bisedo* shtruar;

«pse s'kuvëndon mirë»; *lufto* si të duash, kot e ke;

*mendo*, pra folë, etj. ku përdorimi i emrit në kallëzore është i pa-nevojshëm e gati gati i papranueshëm, dhe për pasojë veprimi i shprehur prej tyre parafytyrohet i paushtruar mbi dikë a diçka, këto folje do t'i marrim të reksionit intranzitiv, ndërsa në konstruktet:

— Ngarkoje më rëndë, se *duron* akoma, s'prishet (= *duron* peshën).

— Ti e *gjykon* vetë; ai e *bisedoi* dhe me mua;

— Mjeku *lufton* sëmundjet, etj., ku këto folje, ose e kanë pranë emrin në rasën kallëzore, ose, sikurse thotë Sh. Demiraj<sup>13</sup>, kanë mundësi ta marrin këtë e madje e kanë të domosdoshëm pavarësisht të shprehur apo të nënkuptuar, ne do t'i marrim si tranzitive, por, theksojmë, duke e konsideruar një inovacion relativisht të vonë.

Duhet pasur parasysh që foljet e këtij nëngrupi (Ia) vazhdojnë të mbeten intranzitive dhe nuk kalojnë në tranzitive të zhdrejta edhe në përdorimet idiomatikë të tipit: *i vdiq i ati*, *i kaloi koha*, *i plasi besa*, *i qeshi fati* etj. dhe vetorët e patheksuar në dhanore semantikisht janë pronorët përkatës. Pra, për ne, mendimi i S. Priftit<sup>14</sup> që këto dhanore janë plotësa kufizimi ose kthehen në kundrina, kur folja ndryshon nuancë kuptimi, s'është i drejtë. Sipas mendimit tonë, këtu s'kemi kundrina të zhdrejta, por plotësa që shprehin raporte përkatësie a dobie (pra, që kjo gjë i përket ose bëhet në të mirë të atij (asaj etj.), për të cilin bëhet fjalë. Kështu në fjalitë e mësipërme shprehet idea e pronësisë: *Ati i tij (prkt. i saj) vdiq, koha e tij (e saj) kaloi, besa e tij (e saj) plasi, fati i tij (i saj) qeshi*.

Ib. Nëngrupi i dytë që përfshin foljet me reksion intranzitiv e tranzitiv të drejtë, përbëhet nga ato folje reksioni primar i të cilavet është tranzitivi dhe vetëm si reksion sekundar kanë fituar, me kalimin e kohës, edhe atë intranzitiv p.sh.

— Planin, që kam kohë që mundohem, e *përfundova* kështu. (tr. e dr.) F. Postoli: Lulja e Kujtimit — f. 31

— Loja *përfundoi* në fitim të miqvet (intr.)

— Ai *mbaroi* pa gdhirë mirë (= vdiq) (intr.)

— I *humba* të gjitha shpresat (tr. e dr.)

— *Humbi* shpresa, *humbi* jeta. (intr.)

Në këtë nëngrup foljesh hyjnë: *afroj*, *bëj*, *çel*, *dalloj*, *dërmoj*, *di*, *diskutoj*, *dredh*, *dua*, *filloj*, *fitoj*, *gdhij*, *godit*, *kursej*, *lëshoj*, *prek*, *takoj*, *zgjat*, etj. Edhe në përdorimet idiomatikë të foljeve të këtij nëngrupi do të vërejmë të njëjtën gjë si në nëngrupin e parë Ia. Dhanoret përkatëse në konstruktet: *i shkriu jeta*, *i humbi lapsi*, *i shpëtoi vëllai*, *i luajti dora* etj. shprehin qartë idenë e përkatësisë (pronësisë) e për pasojë s'janë kundrina të zhdrejta, por plotësa. Pra, shprehjeve të mësipërme u përgjigjen respektivisht, *lapsi i tij humbi*, *vëllai i tij shpëtoi*, *jeta e tij shkriu*, *dora e tij luajti* etj.

Që trajtat e shkurtëra të përemrave vetorë në rastet e lartpërmendur u përgjigjen pronorëve përkatës, del e qartë po të hedhim një vështrim në gjuhë të tjera p.sh. në frengjishten, ku s'mund të thuhet:

13) Sh. Demiraj: vepër e cituar, fq. 170

14) S. Prifti: «Sintaksa e gjuhës shqipe» Disp. I, Tiranë, 1959, fq. 119

i humbi lapsi, i shpëtoi jeta, etj. por vetëm; *lapsi i tij humbi, jeta e tij shpëtoi*, etj. Po kështu edhe në gjermanishten, megjithëse në popull mund të hasen përdorime analoge me shqipen, në mbarë gjuhën letrare ekziston një rregull e njëjtë me atë të frengjishtes.

\* \* \*

Që të gjitha foljet tranzitive direkte përdoren edhe pa kundrinë të shprehur. Por ka folje tranzitive, të cilat vetëm me vështirësi mund të përdoren *pa* kundrinën e drejtë, si p.sh.: *marr, bëj, jap, kam* etj. dhe ka folje, që mund të përdoren *me* ose *pa* kundrinën e drejtë, si p.sh. *lexoj, shkruaj, dëgjoj, shikoj* etj. Në trajtimin e këtyre foljeve gjuhëtarët janë ndarë në mendimet e tyre: disa, duke e quajtur kundrinën e drejtë të nënkuptuar edhe kur ajo formalisht mungon, i marrin vetëm si tranzitive; disa të tjerë, duke u mbështetur jo vetëm në anën formale, por edhe në nuancat e reja kuptimore që lindin në përdorimet *pa* kundrinë të shprehur, i marrin tranzitive, kur kundrina është e shprehur dhe intranzitive, kur kundrina mungon, pavarësisht nëse nënkuptohet apo jo. K. Cipua lidhur me këtë çështje thotë: «Kemi folje që *pa* e humbur karakterin tranzitiv nuk e shprehin formalisht kundrinën, se janë aso foljesh, që i ka gjithësecili në majë të gjuhës, siç janë *me ngrënë* e *me pi*: *ha e pi* katër herë në ditë.»

Sh. Demiraj nënvizon se «edhe kur kundrina e drejtë mungon në një fjali, folja do të merret tranzitive në rast se është përdorur në një kuptim, i cili e lejon të marrë një kundrinë të drejtë, siç është rasti i foljevet *ha pi* në këto dy vargje. Pa *ngrënë* e pa *pirë* / s'mbetemi moj Mirë. Po kështu dhe foljet *lexoj e shkruaj* në frazën: *Ai lexon e shkruan mirë* — janë tranzitive, sepse janë përdorur me një kuptim që i lejon të marrin kundrina të drejta p.sh.: *Ai po shkruan një letër; ai lexon gazetën çdo ditë.*»

Regula Moritz, kur trajton rastet e kalimit të një foljeje nga tranzitive në intranzitive e anasjelltas, përdorimet *pa* kundrinë të drejtë të foljevet tranzitive i merr si kalime të këtyre të fundit në grupin e foljeve intranzitive, duke e quajtur «një çfaqje të rëndomtë të gjuhës teknike: *ai fiton; ai humbet; puna fisnikëron; ku gjithçka dashuron Karli vetem s'mund të urrejë*»<sup>15</sup>

Me dy autorët vendas, simbas të cilëve folja tranzitive e drejtë vazhdon të mbetet e tillë edhe atëherë kur kundrina e drejtë nuk shprehet, ne bashkohemi në parim, sepse veprimi i të *lexuarit, të shkruarit, etj.* me të vërtetë nuk mund as të kryhet as madje të parafytyrohet pa u ushtruar mbi një objekt, pavarësisht në se ky është i shprehur apo i nënkuptuar.

Por shtojmë se arësyet për të cilat ndodh kështu janë të tjera e jo sepse këto folje «gjithësecili i ka në majë të gjuhës». Në fakt, kjo nuk ndodh aspak rastësisht e pa qëllim, por për arësye pikërisht semantike.

Prandaj foljet e reksionit tranzitiv të drejtë, më shkurt foljet tranzitive të drejta ne do t'i dallojmë: 1) në tranzitive të drejta me kun-

15) Regula Moritz: «Grundlegungen und Grundprobleme der Syntax» f. 115-116, Heidelberg — 1951.

drinë të shprehur në kontekstin e dhënë, — dhe 2) në tranzitive të drejta me kundrinë të pashprehur në kontekstin e dhënë. Në rastin e fundit kundrina lihet e pashprehur për arsye se folësi a shkruesi ka për qëllim të përqëndrojë vemendjen e dëgjuesit a lexuesit jo njëherazi edhe mbi kundrinën e drejtë të veprimt, por vetëm mbi kuptimin leksikor të foljes. Pra, sikurse thotë Grozdjevi, «në këta raste vemendja përqëndrohet në veprimin, në vetitë e vepruesit. Këto folje-nënvizon ai — afrohen përnga kuptimi me intransitivitet, duke karakterizuar veprimet tipikë të gjendjes, shprehinë».<sup>16</sup> Këtu duhet pasur parasysh lidhja e shprehisë me aspektin foljor dhe jo me kohën e foljes. Kemi shprehë për aspektin vijë (të vazhdimësisë), por jo për atë punktual (pikë).

Pra, në fjalinë : ai *këndon* mirë, — kemi tregim të shprehisë ; ndërsa në rastin tjetër : ai *këndoi* mirë dje, — ku është e njëjta folje por në një kohë me aspekt pikë, nuk kemi çfaqje të shprehisë. Në rastin në fjalë, siç thuhet edhe në gramatikën e Akademisë së Shkencave të B.S., fitohet një nuancë e re kuptimore : «merrem me veprimin që shpreh folja ose kam të bëj me veprimin që shpreh folja.»<sup>17</sup>

Si përfundim, nga ana kuptimore ka ndryshim midis dy përdorimeve : 1) Ai *lexon e shkruan* mirë, — ku jepet vetia e vepruesit, veti kjo që e dallon nga të tjerët (p.sh. : më parë ai s'dinte (ishte analfabet), por tani lexon e shkruan mirë ; ose : ai të merret me këtë punë, se shkruan mirë (pra, e ka shprehë), dhe 2) Ai *lexon gazetën* perditë ose ai *shkruan një letër*, — ku nuk tregohet veti a shprehë, por lloj veprimi e për më tepër çfarë ose kush e pëson atë.

II. Nëngrupi i dytë i foljeve me dy reksione përfshin ato folje që në mbarë gjuhën letrare përdoren kryesisht me reksion intransitiv, dmth. me reksion zero, por në disa bashkime sintaktikë përdoren edhe me reksion tranzitiv të zhdrejtë. Këtu ekziston vetëm ky tip, rasti i anasjelltë është i pamundur; nuk ka, pra, folje që të kenë si reksion primar tranzitivin e zhdrejtë dhe si sekundar atë intransitiv. Në këtë nëngrup hyjnë kryesisht foljet që tregojnë *lëvizje në hapësirë* ose *gjendje* e që (sikurse shprehet S. Riza në punimin e tij të cituar më lart) «në cilësinë e një veçorie idiomatike të gjuhës sonë, pra, në cilësinë e një albanizmi, mund të shndërrohen në folje *veprimi të ushtruar zhdrejtazi* mbi diçka e për pasojë në një folje tranzitive të zhdrejtë.» Po japim disa shembëlla:

— Ku *hyn* dielli, nuk *hyn* mjeku. (intr.)

— Ç't'u desh t'i *hyje* kësaj pune... (tr. e zhdr.) I. Kadare : Gjenerali i ushtrisë së vdekur. F. 146.

— Evgjenia po ia *hynte* një valleje të madhe (tr. e zhdr.) V. Sejko : Orë të vështira, F. 21.

— Ata *dolën* për vizita ndër miqtë (intr.)

— Ose do të *kthesh* rrugë, ose do të *ndahemi*, kështu nuk i *delet*. (tr. e zhdr.)

— I paskish *dalë* zot atdheut dhe vegjëlisë. (tr. e zhdr.) N. Bulka : Skica dhe tregime f. 27

— Apo kur vë dorë Partia, s'ka punë që të mos i *delet* mb'anë ? (tr. e zhdr.) Sh. Musaraj : Të shkuara... f. 50

16) Vepër e cituar.

17) Vepër e cituar.

— Le që *s'rri* dot pa punë unë (intr.) V. Sejko: Orë. . f. 17

— Duhet *t'i rrimë* punës sipër (tr. e zhdr.)

Këtu hyjnë folje të tilla si: *rri*, *hyj*, *dal*, *bie*, etj. Sikurse mund të shihet lehtë, në këtë nëngrup hyjnë një numur mjaft i vogël foljesh. Këtu, siç u tha më lart, kemi të bëjmë me një veçori idiomatike të gjuhës, kjo veçori sa vjen e bëhet më e zakonshme, sa vjen e më tepër folje hyjnë në këtë nëngrup.

III. Nëngrupi i tretë përfshin foljet që në disa bashkime sintaktike kanë reksionin tranzitiv të zhdrejtë e në disa të tjerë tranzitivin e drejtë. Se cili nga këta të dy reksione është më i përhapuri, e kemi vështirë të themi, sepse për këtë do të na duhej një gjurmim statistikor mbi gjendjen e sotme e madje mbi zhvillimin historik të këtij fenomeni në gjuhën tonë dhe jo vetëm në atë letrare, por edhe nëpër dialektet e shqipes.

Duhet shënuar se në shprehjet: *e besoj shokun* — *i besoj shokut*; *e kundërshtoj* — *i kundërshtoj*; *e ndihmoj shtëpinë* — *i ndihmoj shtëpisë*; *e përballoj* — *i përballoj* etj., nuk kemi dy kuptime qartësisht të ndryshëm, por dy theksime lehtësisht të dallueshëm, stilistikisht të pabarabartë.

Një gjë të tillë e ka vënë re drejtë edhe S. Prifti<sup>18</sup>, por mendimi i tij pasues: «Por këto folje si edhe shumë të tjera, mund të marrin njëkohësisht kundrinë në kallëzore dhe në dhanore, p.sh. Ti i sjell një ndihmë të madhe shtëpisë; por edhe unë i bëj një shërbim jo të pakët kolektivit tonë»<sup>19</sup>, simbas pikëpamjes sonë, është i padrejtë, sepse sjell një ndihmë është përkufizimi i foljes *ndihmoj*, por folja *sjell s'është* aspak e barabartë me foljen *ndihmoj*, që ne të pranojmë sa thuhet më lart. Pra, ne jemi të mendimit se këto mund të marrin ose një kundrinë të zhdrejtë e të vetme ose një të drejtë, por jo dy njëherazi.

Në këtë nëngrup hyjnë folje të tilla si: *besoj*, *ndihmoj*, *përballoj*, *kundërshtoj*, *interesoj* etj.

\* \* \*

B. Grupin e dytë të foljeve me më se një reksion e përbëjnë ato me tre reksione: 1) intranzitiv, 2) tranzitiv të zhdrejtë dhe 3) tranzitiv të drejtë. Këtu hyjnë folje të tilla si: *arrij*, *mbërrij*, *flas*, *gjimtoj*, *shkoj*, *thom*, *thërras*, *shërbej*, *fryj*, *çfryj* etj. Lidhur me format: *ia arrij*, *ia mbërrij* S. Prifti<sup>20</sup> mendon se «në përsëritjen e kundrinës në trajtën e shkurtër të përemrit *vetor dalin të dyja kundrinat bashkë*, ajo e rasës dhanore dhe ajo e rasës kallëzore, p.sh. «Po ja marrim këngës shumë bukur; ata ja thonë për merak...» Sh. Demiraj<sup>21</sup> mendon se në këto shprehje «trajta e shkurtër e rasës kallëzore e (këtu *ia*) është përdorur në mënyrë pleonastike. Kjo duhet të jetë shkaktuar nga analogjia me përdorimin e këtyre dy trajtave të shkurtëra të bashkua-

18) Vepër e cituar, f. 118

19) Vepër e cituar, f. 118;

20) Vepër e cituar, f. 119;

21) Vepër e cituar, f. 113

ra në shprehje të tilla si *ia mora mendjen* (fjalën etj)...» Edhe në mendojmë se *ia* në këta raste historikisht do të ketë ardhur nga *i + e*, ku *e* përfaqëson një kundrinë të drejtë, por në kontekstet e lartpërmendur të pashprehur asnjëherë. Kjo mund të ketë ardhur, siç mendon Sh. Demiraj, ose nga një kontaminim midis përdorjes së foljes me reksion tranzitiv të zhdrejtë me përdorjen me reksion tranzitiv të drejtë :

*i arrij* — *e arrij* > *ia arrij*. Kështu p.sh. në Korçë thuhet *e hip biçikletën*, në mbarë gjuhën letrare thuhet : *i hip biçikletës*, dhe në gjuhën jo rreptësisht letrare : *ia hip biçikletës*. Nga këta përdorime sporadikë nënë veprimin e analogjisë, mund të jetë përgjithësuar. Po japim disa shembëlla nga ky grup :

I. — Aq bukur *flet* sa s'ka më (intr.)

K. Floqi : Burri burrë. f. 35

— *Folë, folë*, lejen e ke me pash (intr.)

poaty — f. 33

Në të dya këto shembëlla folja *folë* ka kuptimin : çfaq gjuhësisht mendimet.

2. — E pastaj *i foli* sëmës me atë tonin e tij të prerë e të patron-ditur. (tr. e zhdr.) V. Sejko : Orë të vështira — f. 24

— Kujt *i flet* moj urate madhe? (tr. e zhdr.)

poaty — f. 29

— Kujt tjetër do t'i flasja? (tr. e zhdr.)

poaty — f. 30.

Në këta konstrukte folja *folë* mund të tregojë : a) i drejtoi fjalën ; b) i bëri zë që larg ose c) i hoqi vërejtjen, e qërtoi.

3. — Gjithë ditën *s'foli* një fjalë të mirë (përdorim me kundrinë të brëndëshme) (tr. e dr.)

— E *flet* rusishten sikur ta kishte gjuhën amtare. (tr. e dr.)

— Kë e kë *fole* për darkë (= ftove) (tr. e dr.) (me kundrinë të mirëfilltë)

Ose:

— Këto ditë *shkon* një delegacion jashtë shtetit (intr.)

F. Gjata; Këneta — f. 212

— *Shkoj* perin në gjilpërë (tr. e dr.)

— Mirë i thonë fjalës : «në punët e bujqësisë edhe plaku më i mykët *ia shkon* një gruaje të re. (tr. e zhdr.) S. Caci : Doni i qetë (përkthim) V. IV f. 216

— Mos *thirrë*, se na shurdhove (= mos bërtit) (intr.)

— Patat e egëra *i thërrisnin* shoqja shoqes, ... (tr. e zhd.)

(= i bënin zë) S. Caci : Doni... V. IV — f. 231

— Toka *i thërriste*, *i thërriste* pa u lodhur nat' e ditë... (= i ftonte) S. Caci : Doni... V. IV, f. 242.

Edhe numri i foljeve të këtij grupi është relativisht i vogël, por ky numur vjen duke u shtuar pa ndërprerje me kalimin e kohës.

\* \* \*

*Disa mendime mbi shkaqet dhe drejtimet e lëvizjes së reksionit të foljeve* — Thënia e filozofit të madh grek, Heraklitit : «Gjithçka rrjedh» është e plotvlerëshme edhe për gjuhën. Ajo është në ndryshim e zhvillim të vazhdueshëm, pavarësisht nga fakti që ndryshimet në të ndo-

dhin shumë ngadalë e pa u vënë re. Këtij ligji të përgjithshëm i nënë-shtrohet edhe reksioni foljor.

Pluriresksionaliteti në përgjithësi është një evolucion relativisht i vonë dhe i papërfunduar, gjithmonë në vazhdim, gjithmonë vjen duke u pasuruar. Folje që deri para disa kohësh përdoreshin me një reksion të vetëm prkt. me dy, sot rezultojnë me dy ose me tre reksione. Kjo duket qartë në mospërputhjen e reksionit duke kaluar nga gjuha e folur, që zakonisht është më konservative dhe që ka më pak nuanca kuptimore për të shprehur, në gjuhën e shkruar, ku letrari ndien vazhdimisht nevojën për të diferencuar stilistikisht forcën shprehëse të foljeve. Një gjë e tillë vihet re qartë, po të hidhet një vështrim qoftë në veprat e autorëve bashkëkohorë qoftë në shtypin e përditshëm.

Një faktor tjetër i rëndësishëm që shkakton inovacione në reksionin e foljevet në gjuhën letrare e për pasojë mospërputhjen e tij me reksionin e foljevet në gjuhën e folur, është edhe fakti që shkrimtarët dhe gjuhëtarët, nënë ndikimin e gjuhëve të huaja që zotërojnë, mund t'i lejojnë vehtes inovacione në fushën e reksionit foljor. Kështu p.sh. F. Postoli foljen tranzitive të drejtë: *meritoj* e përdor edhe si intranzitive, mendojmë nënë ndikimin e foljes greke *aksizo*<sup>22</sup>: Jam mejtuar shumë herë për të gjetur burrin që i *merton* asaj. (Lulja e kujtimit f. 30) Po kështu F.S. Noli: Zonjat e *shërbejnë* djalin

vajzat ia ushqejnë kalin.

Don Kishoti — f. 23

ose: *Perpjet pri* — e Shqipërinë

F.S. Noli, Hymni i Flamurit

(qoftë nënë ndikimin e gjermanishtes *bedienen* qoftë nga frengjishtja *servire quelqu'un*)

Ose:

Kjo ndodh edhe kur fjalia e varur *prin* kryesoren.

S. Floqi: Periudhë me fjali të varur shkakore,

punimi i pabotuar f. 5

...poeti ynë prodhon me një nxitim të madh e cila i demton artit. Mitrush Kuteli: Ylli i Zemrës, f. 144

...kjo gjë i *dëmton* fort letërsisë shqiptare, poaty — f. 143

E njëjta gjë ndodh edhe me foljet *kërcënohem* e *shmangem*, që zakonisht janë mesore, por që jo rrallë përdoren si tranzitive të drejta p.sh.

— Imperializmi *kërcënon* paqen në botë.

— Duhet të *shmangim* të metat në punë.

Shënuam se për karakterin primar apo sekundar të njërit a tjetrit reksion jemi mbështetur në FI, por me gjithatë shpesh edhe ky nuk ka mundur të na japë dorë dhe është vështirë të përcaktohet egzak-tërisht cili nga dy reksionet është primari. Shpesh edhe në gjuhën e folur apo nëpër të folme të ndryshme hasen folje me më se një reksion, kështu që vështirësohet çështja edhe më tepër. Në këtë mes ne do të ndihmohemi nga parimi që prirja e përgjithëshme e folësit a shkruerit është për ta shprehur sa më drejtpërdrejtë, sa më theksueshëm te ush-truarit e veprimit mbi objektin përkatës. Kjo prirje ka bërë që lëvizja e përgjithëshme e reksionit të jetë: nga intranzitivi në tranzitivin e

22) Simbas një kumtimi nga K. Bozhori.

zhdrejtë a direkt në atë të drejtë dhe nga tranzitivi i zhdrejtë në atë të drejtë. Jo rrallë, siç del nga studimi i grupeve përkatës, kemi kalim direkt të reksionit intranzitiv në atë tranzitiv të drejtë. Kjo prirje ka bërë pra, që, edhe në rastet kur foljes nga natyra e gjuhës i mungonte një aftësi e tillë, dalngadalë, me kalimin e kohës, iu shtua.

Mendojmë gjithashtu se reksioni i drejtë do të ketë ardhur në mbarë gjuhën (për rastet që zakonisht mungonte e që sot është i pranishëm) nga letrarishtia edhe për arsye se ky lejon edhe përdorimin e diatezës pësore, gjë që, siç u tregua më lart, për disa veta është e pamundur në reksionin intranzitiv dhe tranzitiv të zhdrejtë.

\* \* \*

### — Konkluzion —

Reksioni i një foljeje është paaftësia prkt. aftësia e saj për të sunduar a drejtuar një emër në këtë apo atë rasë, e rrjedhimisht për të bashkëbartur këtë apo atë lloj plotësish kundrinorë. Reksioni i foljevet përbën njërin nga tiparet më idiomatikë në strukturën gramatikore të një gjuhe. Në gjuhët indoeuropiane foljet me një reksion të vetëm ose unireksionale mund të thuhet se janë më të rendomt. Por në të njëjtat gjuhë edhe foljet, të afta për t'u ndërtuar me më se një lloj plotësish kundrinorë, nuk përbëjnë ndonjë çfaqje të pazakontë e aq më pak anormale. Këto folje quhen plurireksionale ose me më se një reksion.

Plurireksionaliteti i një foljeje zakonisht kushtëzohet nga polisemia e saj, por megjithatë i pari dallohet qartë prej së dytës.

Përdorja e një foljeje tranzitive me kundrinë të shprehur në konstrukte të caktuar duhet dalluar nga përdorja e saj pa kundrinë të shprehur. Në rastin e fundit, folja vazhdon të mbetet e reksionit tranzitiv të drejtë, por fiton nuanca të reja kuptimore.

Për ato folje, të cilat në krye të herës kanë qënë unireksionale, veçoria gjuhësore e plurireksionalitetit është rezultat i një evolucioni relativisht të vonë e madje ende të papërfunduar, sepse është gjithnjë në lëvizje e sipër. Drejtim i përgjithshëm i kësaj lëvizjeje është kalimi nga reksioni intranzitiv në atë tranzitiv dhe nga tranzitivi i zhdrejtë në atë të drejtë. Shkaqet e kësaj lëvizjeje janë: a) prirja e folësvet për të shprehur t'ushtruarit e veprimet mbi objektin përkatës në një mënyrë sintaktikisht sa më direkte; b) synimi i letrarëvet për të diferencuar stilistikisht forcën shprehëse të foljevet; c) ndikimi i gjuhëvet të huaja mbi letrarët dhe gjuhëtarët; ç) mundësia e foljevet të reksionit tranzitiv të drejtë për t'u përdorur edhe në diatezën pësore.

Si rrjedhim, reksioni i foljevet në gjuhën e folur jo rrallë ndryshon nga reksioni i tyre në gjuhën letrare.

## R é s u m é

APERÇU SUR LES VERBES A PLUS D'UNE RECTION  
DANS L'ALBANAIS LITTERAIRE D'AUJOURD' HUI

La rection d'un verbe est son incapacité respectivement sa capacité à régir ou gouverner un nom dans un cas ou dans un autre, et par conséquent à comporter telle ou telle sorte de complément d'objet. La rection des verbes constitue un des traits les plus idiomatiques dans la structure grammaticale d'une langue. Dans les langues indo-européennes, les verbes à une seule rection ou unirectionnels peuvent être considérés comme les plus communs. Mais, dans les mêmes langues, les verbes capables à comporter plus d'un genre de compléments, ne constituent pas un phénomène inhabituel et, d'autant moins, anormal. Ces verbes sont appelés plurirectionnels ou à plus d'une rection.

Le caractère plurirectionnel d'un verbe est conditionné habituellement par sa polysémie ; néanmoins on a une distinction nette entre l'un et l'autre.

Les verbes plurirectionnels de l'albanais nous les divisons en deux groupes :

A) Verbes à deux rections ;

B) Verbes à trois rections.

Les verbes du groupe A nous les subdivisons en trois sous-groupes :

I. Verbes à rection 2) intransitive et 2) transitive directe ;

II. Verbes à rection 2) intransitive et 2) transitive indirecte ;

III. Verbes à rection 1) transitive indirecte et 2) transitive directe.

Pour ce qui est de la priorité de ces rections, tout sous-groupe se subdivise encore en deux autres sous-groupes: où il est tantôt 1) primaire et 2) secondaire, et tantôt inversement.

L'emploi d'un verbe transitif avec complément d'objet exprimé doit être distingué de son emploi inverse. Même dans ce dernier cas, le verbe reste toujours de rection transitive directe, mais il acquiert des nuances sémantiques.

Pour les verbes qui tout d'abord ont été unirectionnels, la particularité linguistique de la plurectionnalité est le résultat d'une évolution relativement tardive, et même pas encore terminée, celle-ci étant toujours en mouvement. Le sens général de ce mouvement est le passage de la rection intransitive à celle transitive et de la transitive indirecte à celle directe. Les causes de ce mouvement sont les suivantes : a) la tendance des sujets parlants à exprimer l'exercice de l'action sur l'objet respectif de la façon la plus directe possible au point de vue de la syntaxe ; b) la tendance des littérateurs à différencier au point de vue stylistique la force d'expression des verbes ; c) l'influence des langues étrangères sur les littérateurs et les linguistes ; d) la possibilité qu'ont les verbes de rection transitive directe à être employés aussi dans la diathèse passive.

Voilà pourquoi il n'est pas rare que les verbes changent de rection en passant de la langue parlée à celle écrite.

